



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 411/10 prot.

Tiranë, më 25.09.2018

### V E N D I M

**Nr. 81, datë 25/09/2018**

#### **PËR MIRATIMIN E RAPORTIT PËRFUNDIMTAR TË MBIKËQYRJES SË ADMINISTRIMIT TË SHËRBIMIT CIVIL NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË SHËRBIMIT TË PROVËS DHE PARALAJMËRIMIN E INSTITUCIONIT PËR TË RREGULLUAR GJENDJEN E LIGJSHMËRISË**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11 pika 1, 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe të Rregullores, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të materialit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në lidhje me mbikëqyrjen e zhvilluar në institucionin në varësi të Ministrisë së Drejtësisë, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës,

#### **VËREJ SE:**

Me vendimin nr. 32, datë 16.04.2018, “Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në procesin e administrimit të shërbimit civil, në institucionin e Shërbimit të Provës”, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, ka vendosur fillimin e mbikëqyrjes së përgjithshme në lidhje me zbatimin e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, në institucionin, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës.

Objekti i mbikëqyrjes është i përgjithshëm dhe përfshin veprimet administrative të kryera nga njësia përgjegjëse dhe subjektet e tjera të ngarkuara me ligj, si pjesëmarrës në proceset e administrimit të shërbimit civil, prej momentit të fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, e në vijim.

Procesi është zhvilluar në përputhje me Programin e Mbikëqyrjes nr. 411/1 prot., datë 16.04.2018, të miratuar nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, i cili me shkresën nr.411/3 prot., datë 16.04.2018, *“Njoftim për fillimin e procesit të mbikëqyrjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil në institucionin e Shërbimit të Provës”*, i është njoftuar këtij institucioni.

Drejtorja e Përgjithshme e Shërbimit të Provës është pjesë e shërbimit civil, si institucion në varësi të Ministrisë së Drejtësisë dhe funksionon si autoritet përgjegjës për zbatimin e alternativave të dënimit me burgim në Republikën e Shqipërisë, bazuar në kuadrin ligjor në fuqi.

Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, Drejtorja e Përgjithshme të Shërbimit të Provës, përfshihet për herë të parë në skemën e administrimit të shërbimit civil. Përfshirja e saj në *“Listën e institucioneve të administratës shtetërore”*, të cilat janë pjesë e shërbimit civil, është e parashikuar në mënyrë të shprehur në Lidhjen nr. 1 (numri rendor 84), të Vendimit nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”*, të ndryshuar.

Në përfundim të procesit të verifikimit të dokumentacionit dhe grumbullimit të të dhënave, grupi i mbikëqyrjes ka hartuar projekt raportin për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil dhe ia ka dërguar për njohje subjektit të mbikëqyrur me shkresën nr. 411/6 prot., datë 06.07.2018, të Komisionerit, *“Dërgohet projekt raporti në përfundim të mbikëqyrjes në institucionin e Shërbimit të Provës, në lidhje me administrimin e shërbimit civil”*, duke i lënë një afat 15 ditë kohë, për të paraqitur komentet e tyre në lidhje me konstatimet e evidentuara nga grupi i mbikëqyrjes.

Me shkresat nr. 411/7 prot., datë 06.07.2018 dhe nr. 411/8 prot., datë 06.07.2018, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, *“Dërgohet projekt raporti në përfundim të mbikëqyrjes në institucionin e Shërbimit të Provës, në lidhje me administrimin e shërbimit civil”*, projekt raporti i mbikëqyrjes i është dërguar për njohje, respektivisht, Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Drejtësisë, që është ministria nga e cila varet institucioni i mbikëqyrur dhe Departamentit të Administratës Publike, në cilësinë e njësisë përgjegjëse në këtë rast.

Ndërkohë, subjekti i mbikëqyrur, pasi është njohur me projekt raportin dhe gjetjet e grupit të punës, me shkresën nr. 2997 prot., datë 27.07.2018, *“Observacioni mbi projekt raportin në përfundim të mbikëqyrjes në institucionin e Shërbimit të Provës në lidhje me administrimin e shërbimit civil”*, regjistruar pranë Komisionerit me nr. 411/9 prot., datë 31.07.2018, ka dërguar projekt raportin e nënshkruar nga personat përgjegjës.

Nga përmbajtja e shkresës përcjellëse rezulton se, subjekti i mbikëqyrur është shprehur dakord në përgjithësi me rekomandimet e nxjerra nga grupi i punës, por ka pasqyruar disa sqarime në lidhje me gjetjet në projekt raport, të cilat janë analizuar me hollësi në përmbajtjen e raportit përfundimtar dhe u administruan në dosjen e mbikëqyrjes.

Konstatohet se gjatë procesit të mbikëqyrjes në këtë institucion, nga ana e grupit të mbikëqyrjes janë evidentuar shkelje të dispozitave ligjore, të cilat i janë komunikuar institucionit dhe nga ana e nëpunësve përgjegjës, është reaguar menjëherë, duke rivendosur ligjshmërinë në një pjesë të madhe të parregullsive që janë konstatuar në momentin e këqyrjes së dokumentacionit dhe verifikimit në subjekt të situatës së administrimit të shërbimit civil.

Ky fakt është pasqyruar edhe në përmbajtjen e raportit përfundimtar, në të cilin janë evidentuar parregullsitë dhe njëkohësisht është sqaruar edhe situata konkrete në momentin e hartimit të këtij materiali dhe të vendimit përfundimtar të paralajmërimit të institucionit për të rregulluar situatën ligjore.

Sa më sipër, çmoj se janë kryer të gjitha procedurat e nevojshme që sigurojnë transparencën e procesit dhe mundësinë e institucionit të kontrolluar për të shprehur pretendimet e tij në lidhje me problematikën e evidentuar.

Në këto rrethana, pasi shqyrtova raportin përfundimtar të mbikëqyrjes, të paraqitur për miratim nga grupi i punës, vlerësoj se duhet të miratoj përmbajtjen e tij.

#### **Për këto arsye:**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, referuar Seksionit III, “Procedura hetimore”, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

#### **V E N D O S A:**

1. Të miratoj përmbajtjen e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së përgjithshme, në lidhje me administrimin e shërbimit civil, në institucionin Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës dhe të paralajmëroj institucionin për të rregulluar situatën e paligjshmërisë në zbatimin e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, duke kërkuar zbatimin e detyrave që do të specifikohen më poshtë.
2. Për të rregulluar situatën e paligjshmërisë në rastin e emërimit në kundërshtim me ligjin, për punonjësen \*\*\*\*\*, Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit të Provës, të konstatojë menjëherë pavlefshmërinë absolute të aktit të emërimit nr. 1173, datë 25.05.2017, të punonjëses në pozicionin e punës, “Specialist, në Zyrën Vendore të Shërbimit të provës, Tiranë”, në përputhje me nenin 110, të Kodit të Procedurave Administrative dhe të rregullohen pasojat duke vendosur menjëherë përfundimin e marrëdhënies së punës. Neni 23, pika 4, i ligjit për nëpunësin civil, e cilësojnë aktin e emërimit në këtë rast si absolutisht të pavlefshëm, i cili nuk mund të prodhojë pasoja ligjore.

Pozicioni i punës “*Specialist, në Zyrën Vendore të Shërbimit të provës, Tiranë*”, të shpallet i lirë dhe të plotësohet nëpërmjet konkurrimit.

3. Pozicioni i punës “*Arkivist*”, pranë Zyrës Vendore të Shërbimit të Provës, Tiranë, duhet të konsiderohet si pozicion pune pjesë e shërbimit civil, nga ana e njësisë përgjegjëse, Departamentit të Administratës Publike dhe të reflektohet në strukturën e institucionit.
4. Njësia përgjegjëse (DAP), duhet të shprehet në lidhje me deklarimin e statusit të punësimit “*nëpunës civil*”, për punonjësën \*\*\*\*\*, në pozicionin e punës, “*Specialiste, në Zyrën Vendore të Shërbimit të Provës, Tiranë*”, në zbatim të kërkesave të nenit 67, pika 3, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar.
5. Njësia përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore të institucionit, të përfundojë procesin e hartimit të përshkrimeve të punës, për të gjitha pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil, në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Provës, sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara në Vendimin nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura*”, të ndryshuar dhe sipas orientimeve në raportin përfundimtar të mbikëqyrjes, duke e vijuar këtë proces si më poshtë:
  - ✓ Të kërkojë zyrtarisht mendimin e Departamentit të Administratës Publike, për vlerësimin e ligjshmërisë së formularit të përshkrimit të punës për çdo pozicion pune në shërbimin civil, nëse është në përputhje me legjislacionin specifik të fushës apo formatin standard të miratuar.
  - ✓ Pas marrjes së konfirmimit nga njësia përgjegjëse (DAP), të vijojë procesi me miratimin dhe nënshkrimin e përshkrimeve të punës, nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së linjës, në ndarjen përkatëse, siç parashikohet në pikën 18, shkronja “c”, të Vendimit nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave.
  - ✓ Pas miratimit, nënshkrimit dhe dokumentimit të përshkrimeve të punës, një kopje e tyre, të bëhet pjesë e dosjes së personelit të çdo nëpunësi civil dhe një kopje të depozitohet pranë Departamentit të Administratës Publike.

Njësia përgjegjëse, në lidhje me këtë aspekt, të njoftojë të gjithë punonjësit e ngarkuar me detyra specifike në lidhje me përshkrimin e punës (*analisti i punës, eprori direkt dhe nëpunësi civil që kryen detyrat në pozicionin konkret*) për detyrat e lëna nga Komisioneri në këtë vendim, me qëllim që të marrin masa për përfundimin e tyre brenda afatit të paralajmërimit. Nëse pas përfundimit të këtij afati nuk është rivendosur situata e ligjshmërisë, atëherë secili punonjës që nuk ka kryer detyrën do të mbajë përgjegjësi personale sipas parashikimeve të ligjit për nëpunësin civil.

6. Njësia përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore të institucionit, të plotësojë dosjen e personelit të çdo nëpunësi civil, duke përfshirë në të, të gjitha dokumentet dhe të dhënat sipas lidhjeve 1 e 2, pjesë e Vendimit nr. 117, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të*

*regjistrit qendror të personelit*”, si dhe ato të evidentuara në mungesë në tabelën aneks nr. 2, e cila është pjesë e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes.

7. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat **60** ditë nga marrja dijani për këtë vendim. Institucioni i mbikëqyrur dhe njësia përgjegjëse, duhet të zbatojnë këtë vendim duke u bazuar në orientimet e dhëna në përmbajtjen e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes.
8. Me kalimin e këtij afati, subjekti i mbikëqyrur, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës duhet të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi, si dhe të paraqesë të gjitha aktet administrative që vërtetojnë masat e marra.
9. Për këtë vendim të njoftohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Drejtësisë dhe Departamenti i Administratës Publike, duke i dërguar një kopje të raportit përfundimtar të mbikëqyrjes dhe njëkohësisht, të informohet Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut në Kuvendin e Shqipërisë.
10. Në rast të moszbatimit të këtij vendimi paralajmërues, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës për mos zbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONERI**

**Pranvera STRAKOSHA**